

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR-MARS 2024

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	08.01.2024	Kërkesë për nformacion “Shtëpia e Abat Preng Doçit”	09.01.2024	Ne mbështetje të Ligjit Nr. 119/2014 "Per Te Drejten e Informimit", si dhe Ligjit Nr. 27/2018 "Per trashëgimime Kulturore dhe Muzete", Instituti Kombëtar i Trashëgimise Kulturore, nga verifikimi i dokumentacionit arkivor në Arkivin Teknik për banesën "Ish banesa e Abat Docit dhe Tefe Curanit", Bashkia Shkodër, nuk disponon dosje teknike, por vetëm aktin e deklarimit pasuri kulturore të kësaj banese. Gjithashtu ju informojme se nuk është kompetence e IKTK-se dhenia e informacionit mbi juridiksionin e prones. Sa më sipër, ju vendosim në dsipozicion Urdhrin Nr. 527,  Urdher Nr. 527, dt.13.08.2018 Banes. datë 13.08.2018 të Ministrit të Kulturës.	E Plotë	Jo
2	08.01.2024	Kërkesë për material arkivor për objektet si me poshte: 1. Kalaja e Vigut; 2. Ura e Plakut Gjon; 3. Kisha e Shatit; 4. Kisha e Shen Palit, KAbash; 5. Kisha Trikonesh Drisht	12.01.2024	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 08.01.2024, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim ne dispozicion bashkelidhur ne link kopje digjitale te dokumentacionit grafik dhe fotografik qe disponojme per pasurite kulturore si me poshte: 1. Kalaja e Vigut 2. Ura e Plakut Gjon 3. Kisha e Shatit 4. Kisha e Shen Palit, Kabash 5. Kisha Trikonesh Drisht.	E plotë	Jo

				Sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoren materialet arkivore. https://ëëë.transferxl.com/download/08j7b8M3ËLjdm3		
3	09.01.2024	Kërkesë për informacion <i>"Xhamia e Plumbit Shkoder"</i> artikuj ne revista apo/ edhe konferenca material si: relacion teknik, pershkrim historik, si dhe dokumentacion arkitektonik si planimetri, pamje, prerje; si dhe foto.	10.01.2024	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 09.01.2024 për informacion dhe dokumentacion mbi "Xhamine e Plumbit", Shkoder, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 <i>"Për Arkivat"</i> dhe ligjin Nr. 119/ 2014 <i>"Për të drejtën e informimit"</i>, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link materialin arkivor te viteve '70 -te shek XX lidhur me kete pasuri kulturore si me poshtë: • Dokumentacion arkitektonik (plan, pamje, prerje) • Relacion pershkrimor, viti 1986. Mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor. https://ëëë.transferxl.com/download/08jd702nnHzfrL	E plotë	Jo
3	10.01.2024	Informacion per procedurën e licensimit	15.01.2024	Në vijim të kërkesës tuaj, ku kërkonti të informoheni mbi procedurën që duhet ndjekur nga ana e subjektit të cilin ju përfaqësoni, për t'u pajisur me licencë për ndërhyrje në pasuri kulturore materiale, ju sqarojmë si vijon: Bazuar ne VKM Nr. 792, date 7.10.2020 <i>"Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licensimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licensave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licensave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale"</i>, e ndryshuar, kreu II, gërmat 'A' dhe 'C', ju duhet të plotësoni të gjitha kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për licensim. Gjithashtu, gjatë aplikimit duhet të mbani në konsideratë dokumentet shoqëruese, sipas	E plotë	Jo

				përcaktimeve në VKM e sipërcituar, kreu III, gërma ‘C’ e tij. Bashkelidhur këtij e-mail gjeni VKM Nr. 792/2020 .  VKM Nr. 792 - e perditësuar (4).pdf		
4	12.01.2024	Informacion për Bustin e “Themistokli Germenjit”	19.01.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 12.01.2024, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim ne dispozicion bashkelidhur ne link kopje digjitale te dokumentacionit fotografik qe disponojme per pasurine kulturore "Monumenti i Themistokli Germenji", Korçë. Ju informojme se lidhur me objektin e lartpermendur nuk disponojme dokumentacion teknik. Sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoren materialet arkivore. https://ëëë.transferxl.com/doëload/08jpT3NkMXgTtS	E plotë	Jo
5	25.01.2024	Informacion për tre objekte të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019, konkretisht: Ndërtesa e Muzeut Etnografik të Krujës financuar falë programit EU4CULTURE, Kullës së Sahatit dhe Teqesë së Dollmës.	16.02.2024	Në përgjigje të emailit tuaj, ju informojmë si vijon: "Muzeut Etnografik" ne Kruje Ne lidhje me ecurine e punimeve te "Muzeut Etnografik" ne Kruje, shpallur Mmonument Kulture i kategorisë së I-re, fillimisht nga Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës me vendim nr. 6, dt. 15.01.1963 dhe më pas nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës me Vendim Nr.1886, dt.10.06.1973, ju bejme me dije se: Referuar raportit të supervizimit, Punimet restauruese, civile, elektrike dhe mekanike kanë përfunduar në masën 100%. Punimet për multimedian dhe muzealizimin kanë përfunduar në masën 98 %. Multimedia pritet të përfundojë me të gjitha testimet_fund Shkurti 2024. "KULLA E SAHATIT KRUJË"	E plotë	Jo

				Kulla e Sahatit, Krujë - Projekti “Ndërhyrje Emergjente përforcuese në Kullën e Sahatit, Krujë”, miratuar me Vendim Nr. 8, datë 15.01.2021. Punimet për fazën e emergjencës sipas projektit të sipërcituar kanë filluar me 31.03.2021 dhe kanë përfunduar 30.08.2021 konform legjislacionit në fuqi. Projekti parashikonte stabilizimin e përkohshëm të objektit. Me Vendim të KKTKM-së Nr.319, dt.01.07.2022 është miratuar Projekti "Ndërhyrje konservuese dhe përforcimi strukturor “Kulla e Sahatit” Krujë” Monument Kulture Kategoria e I-rë, me aplikues dhe zhvillues CHëB. "TEQJA E DOLLMËS, KRUJË" Me Vendim të KKTKM-së Nr.9, dt.15.01.2021 miratohet Projekti "Ndërhyrje emergjente përforcuese ne Teqenë e Dollmes, Kruje", me aplikues CHëB. Punimet kanë nisur me datë 22.02.2021 me një grafik punimesh prej 12 muajsh. Me Vendim të KKTKM-së Nr.74, dt.08.04.2022 bëhet miratimi i kërkesës së CHëB për shtyrjen e afatit të punimeve me 6 muaj, në projektin “Ndërhyrje konservuese dhe përforcuese në Teqenë e Dollmës, Krujë”.		
6	18.01.2024	Informacin për një Kishë Bizantine, “ <i>Kisha e Shën Mërise</i> ”, ne vitet 400 në fshatin Bishtqethëm Lushnjë.	22.01.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, lidhur me monumentin e Kulturës Kategoria e I “<i>Kisha e Shën Mërisë</i>” në fshatin Bishtqethëm ju bëjmë më dije se: Kisha e Shen Mërise në fshatin Bishtqethëm është shpallur monument kulture me: - Vendim të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës nr. 6, datë 15.01.1963; - Shkresë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Drejtoria e Kultures nr. 68/7, datë 30.05.1970; - Shkresë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës nr.1886, datë10.06.1973. Projekti për restaurimin e këtij monumendi, “<i>Kisha Fjetja e Shën Mërisë Bishtqethëm</i>”, <i>Lushnjë</i>” është miratuar me Vendim nr.146, dt.07.05.2019 të Këshillit	E plotë	Jo

				Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM). Për restaurimin e këtij objekti IKTK ka hartuar Fisha e investimit e cila është përfshirë në Planin e Buxhetit për investim për vitin 2024.		
7	27.01.2024	Kërkesë për vënien në dispozicion të raportit të Qendrës së Përbashkët të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s lidhur me Misionin Këshillimor të ICOMOS, i cili është zhvilluar nga data 26 deri më 28 tetor të vitit 2022.	08.02.2024	Në vijim të kërkesës suaj në të cilën kërkon Raportin e Misionit të Përbashkët UNESCO/ICOMOS për Qendrën e Pasurisë Botërore Butrint, i cili është kryer në datat 26-28 Tetor 2022, ju bëjmë me dije se: Bashkëlidhur gjeni “Raportin e Misionit të Përbashkët Këshillimor të QTB-së dhe ICOMOS në Pasurinë Botërore Butrint”, me 90 faqe gjithsej, i cili është përcjellë nga Ministria e Kulturës me shkresën Nr. 4754/1 Prot., datë 02.10.2023, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 1203 Prot., datë 02.10.2023.	E plotë	Jo
8	28.01.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me legalizimin e objektit informal (Korçë)	08.02.2024	Në vijim të kërkesës së ardhur në datë 28.01.2024, ju informojmë: Është administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (këtu e në vijim "IKTK") kërkesa e ardhur nga ASHK Drejtoria Vendore Korçë, për shqyrtimin e kërkesës për legalizimin e objektit informal me vetëdeklarues _____, mbështetur në VKM Nr. 1040, datë 25.11.2020 " <i>Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimit të modelit të aktit të legalizimit, për ndertimet la leje</i> ". Në lidhje me këtë kërkesë, janë dhënë mendimet nga ana e DRTK Korçë dhe sektori përkatës pranë IKTK-së. Sipas përcaktimeve në VKM e sipërcituar dhe referuar vendodhjes së objektit informal, pritet vlerësimi i autoritetit përgjegjës nëse objekti cënon integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara.	E plotë	Jo
9	06.02.2024	Kërkesë për informacion/material arkivor për “URA E SHKINES NE FSHATIN BLINISHT-ZADRIME" dhe "RRENOJAT E URES SE PLAKUT GJON NE FSHATIN RABOSHTE"	05.03.2024	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim ne dispozicion bashkelidhur ne link kopje digjitale te dokumentacionit arkivor per objektet pasuri kulturore si me poshte:	E plotë	Jo

				- URA E SHKINES NE FSHATIN, BLINISHT-ZADRIME" ; - RRENOJAT E URES SE PLAKUT GJON NE FSHATIN, RABOSHT Sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoren materialet arkivore. https://ëëë.transferxl.com/download/08vDG0QJ7rMrck		
10	07.02.2024	A ka një reagim nga IKTK lidhur me shpalljen e Monumentit “Muret e Portës” në Durrës në programin “7 më të Rrezikuarit” në Europë , nga “Zëri European i Shoqërisë Civile të Përkushtuar ndaj Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore”, e njohur si Europa Nostra, në bashkëpunim me Institutin e Bankës Europiane të Investimeve (EIB) ?	20.02.2024	Ne vijim te emailit tuaj, Ju bëjmë me dije se: Bazuar në Ligjin nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", institucionet e specializuara ne varesie te Ministrise se Kultures (sot Ministria e Ekonomise, Kultures dhe Inovacionit) qe prej vitit 2019, kane marre te gjithë masat e nevojshme ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per trashegimine kulturore per nderhyrjet ne objektin pasuri kulturore “Muret ne Porto Romano” Durres.	E plotë	Jo
11	19.02.2024	Kërkesë për arsye studimore, për banesat: -Banesa Topulli, Interior i dhomes kryesore, pamje e tavanit - Banesa Angoni, Interior i dhomes kryesore, pamje e tavanit - Banesa Hasaf Galanxhi, eksterier - Banesa Toro, eksterier	01.03.2024	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 19.02.2024, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim ne dispozicion bashkelidhur ne link kopje digjitale te dokumentacionit fotografik per pasurite kulturore ne qytetin e Gjirokastrës si me poshte: 1-Banesa Topulli - eksterier (viti 1980, autor H. Collaku) (1 karte); 2-Banesa Angoni- Interior i dhomes kryesore, pamje e tavanit (viti 1978, autor R. Veseli) (1 karte); 3-Banesa Hasaf Galanxhi- eksterier (viti 1969, autor R. Veseli) (1 karte). Ju informojme se per objektin "Banesa Toro", nuk disponojme materiale fotografike. Sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoren materialet arkivore.	E plotë	Jo

				https://ëëë.transferxl.com/doënload/08vjRrJPzpEBqX		
12	01.03.2024	Kërkesë për informacion për objektet: - Gurra e Kodrës (Guri Bardhë, Mat) - Ura e Gurit të Hoxhës (Guri i bardhë, Mat) - Ura e Bukaqit (Bukaq, Kavajë)	04.03.2024	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 01.03.2024, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim ne dispozicion bashkelidhur ne link kopje digjitale te dokumentacionit arkivor per objektet pasuri kulturore si me poshte: - Ura e vogël te Gurra e Kodrës (Guri Bardhë, Mat) (material grafik dhe pershkrimor vitet '80 -te shek.XX); - Ura e Gurit të Hoxhës (Guri i bardhë, Mat) (material grafik, fotografik,pershkrimor si dhe projekt restaurimi viti 2019 hartuar nga IKTK); - Ura e Bukaqit (Bukaq, Kavajë) (material grafik dhe relacion teknik vitet '80 -te shek.XX). Sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoren materialet arkivore. https://ëëë.transferxl.com/doënload/08jQQFRbx93dkLhtps://ëëë.transferxl.com/doënload/08v5ëjcHFFKqHj	E plotë	Jo
13	06.03.2024	Informacion për “Ura e Vashës” (Bashkia Klos, Mat).	18.03.2024	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 06.03.2024, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju vendosim në dispozicion bashkelidhur ne link kopje digjitale të dokumentacionit arkivor që disponojmë në Arkivin Teknik për objektin "Ura e Vashes", Klos: • Skica te viteve 80-te; • Projekt restaurimi viti 2008, 2019 https://ëëë.transferxl.com/doënload/086FMGjëzD3ËB		Jo
14	11.03.2024	Kërkesë për informacion: A është dorëzuar në Qendrën Botërore të Trashëgimisë së UNESCOS Raporti i Shtetit Palë lidhur me Butrintin në kuadër të sesionit të 46 të Komitetit të Trashëgimisë Botërore.	21.03.2024	Në vijim të kërkesës suaj, bashkelidhur gjeni raportin.  Butrint_Mission_Report_FINAL_2023090	E plotë	Jo

[illegible]